

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Mihrie Krasniqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.Z. nga P., rruga “...” blloku ... hyrja ... nr...., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.983/2012 dt.28.10.2013, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar me datë 18.06.2014, në praninë e Prokurorit të Shtetit Bukurie Gjonbalaj, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit Av. F. G.- B. nga Prishtina, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, M. Z., me nofken – M., i biri i S. dhe nënës A., e vajzërisë B., i lindur më dt.*data e lindjes...*, në fshatin H., Komuna e P., tani me vendbanim në P., rruga “...” blloku ... hyrja ... nr...., me numër personal të identifikimit: *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, student i vitit III-të, me profesion tregtar, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar baba i IV fëmijëve, më parë i dënuar, kundër tij zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në paraburgim prej datës **17.02.2013**, e deri më datën **26.03.2013**.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

-Më datë 17.02.2013, rreth orës 20:45, në rrugën magjistrale Prishtinë-Podujevë, i pandehuri M. Z., derisa ishte duke drejtuar automjetin e markës “Mercedes” tipi 200E, ngjyrë hiri dhe me targa regjistrimi *numër i targave...*, me të arritur në vendin e quajtur “Q. e Ll.” në P., në kundërshtim me nenin 49 dhe 54 të LSKRR, nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe të pasurisë në atë mënyrë, që duke mos përshtatë shpejtësinë e lëvizjes së automjetit kushteve të rrugës (kthesë në të djathtë dhe rrugë e lagur) konfiguracionit të rrugës për atë lokacion nuk e shfrytëzon shiritin e komunikacionit sa më afër skajit të djathtë të rrugës dhe si pasojë e kësaj humb kontrollin mbi automjet dhe kalon krejtësisht në shiritin e kundërt të lëvizjes me ç`rast me pjesën e përparme në pjesën e përparme e godet automjetin e markës “VW” tipit CADDY SDI, ngjyrë e gjelbër dhe me targa regjistrimi *numër i targave...*, të cilin e drejtonte i dëmtuari S. S., në shiritin e tij, nga drejtimi Podujevë-Prishtinë, ku si pasojë i dëmtuari ka ndërruar

jetë, pasagjerja Sh. S. sipas ekspertizës mjeko ligjore pëson lëndime të rënda trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, ndërsa A. Z. lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin si dhe shkaktohen dëme materiale të konsiderueshme në automjet.

-Me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4,17,41,42,43,45, dhe nenit 378 par. lidhur me pra. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

I. Të akuzuarin M. (S.) Z. me dënim me burg, ashtu që i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, të cilin do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

II. Konform nenit 83 par. 1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **17.02.2013 deri më dt.26.03.2013.**

III. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate ndërsa në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën **prej 50€ (pesëdhjetë/euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

IV. Të dëmtuarat Sh. S. nga P., rr. “...” nr.... dhe A. Z. nga Prishtina, rr. “...” blloku ..., hyrja ..., nr. ..., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën PP/II.983/2012 dt.28.10.2012, kundër të akuzuarit M. Z. nga P., për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt. 18.06.2014, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij.

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestarë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij Av.F. G.-B., ka deklaruar se në tërësi e pranon fajësinë për të gjitha pikat e Aktakuzës për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe par.1 të KPRK-së, dhe ka theksuar se ndihem shume keq për të ndjerin dhe të

lënduarit, dhe shtoi se ju kërkoj falje familjes së të ndjerit, nga se kjo dhimbje nuk do t'i hiqet gjatë gjithë jetës.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestarë lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin: Se pajtohet me pranimin e fajësisë të pandehurit, pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, dhe është në përputhshmëri me provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, mbi të cilat është mbështetur akti akuzues, dhe i propozoi gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av.F. G. B. në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin: Duke theksuar se pas konsultimit me të mbrojturin tim nuk e ka pasur as më të voglin problem për ta bindur për pranimin e fajësisë, sepse me këtë pranim të fajësisë njëkohësisht provon që ta zbus atë dhimbje që e ka për aksidentin me pasoja fatale që ka ndodhur, dhe ka shtuar se gjykata gjatë matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit do të merr në konsideratë nenin 73 par.1 lidhur me par 3 pika 3.6 nenin 74 par.3 pika 3.10 dhe 3.11 si dhe nenin 75 ku parashihet instituti mbi zbutjen e dënimit që të mbrojturit tim ti shqiptohet një dënim sa ma i ultë duke u bazuar në rrethanat se i mbrojturi im për herë të par ka rënë në kundërshtim me ligjin, pranimi i fajësisë është garancinë se i njëjti nuk do të bie më në kundërshtim me ligjin, është mbajtës i vetëm i familjes, ka katër fëmijë të mitur, fakti se familja S. dhe Z. janë pajtuar sipas traditës përmes ndërmjetësuesve, dhe ka shtuar se si përmbledhje e të gjitha këtyre rrethanave lehtësuese i propozoj gjykatës që ti epet një dënim me kusht apo të shkoj në minimumin e paraparë ligjor duke e dënuar me 6 muaj burgim e që sipas dispozitave të KPRK-së, mund të zëvendësohet me gjobë.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit të akuzuarit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë vullnetarisht, gjykata e vlerësoi dhe analizoi se pranimi i fajësisë ka mbështetje në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit rrugor A. P., të datës 02.03.2013, i cili në mendimin e tij ka theksuar se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur nga lëshimet e drejtuesit të automjetit "A" M. Z., i cili gjatë lëvizjes me automjet para pikës së kontaktit nuk e kishte përshtatë shpejtësinë e lëvizjes së automjetit, kushteve të rrugës dhe konfiguracionit të rrugës në atë lokacion ku si pasoj e kësaj kishte dalë krejtësisht në shiritin e kundërt të lëvizjes me ç'rast me

pjesën e përparme ishte ndeshur me automjetin “B”, ndeshje ballore, po ashtu pranimi i fajësisë ka mbështetje në skicën e vendit të ngjarjes me nr. të rastit 2013 AR 0434 të datës 17.02.2013, si dhe në foto dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Përveç këtij konstatimi të kësaj gjendje faktike të pakontestueshme, pranimi i fajësisë ka mbështetje në Raportin e Autopsisë, i ekspertit mjeko-ligjor Dr. N. H., të datës 17.02.2013, se vdekja e të ndjerit S. S. ka ardhur si pasojë e lëndimeve që janë shkaktuar nga ndonjë mjet i fortë mbretës (siç mund të jetë edhe automjeti), si dhe në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr. N. U. të datës 18.03.2013, e dëmtuara Sh. S. ka pësuar lëndime të rënda trupore me pasoja të përkohshme të shëndetit, dhe e dëmtuara A. Z. ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme të shëndetit.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit me shkelje të neneve 49 dhe 54 të LSKRR, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe par. 1 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës, ashtu që të njëjtin e shpalli fajtor meqë veprën penale e ka kryer nga pakujdesia, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti vetëm faktin se i akuzuari M. Z. gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, kishte sjellje korrekte, dhe ndien shumë keqardhje për familjen e të ndjerit S. S. duke ju kërkuar falje, ishte familjar prind i katër (4) fëmijëve, të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit. Duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti dhe pati parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, në këtë çështje penal-juridike vlera e mbrojtur është jeta e njerëzve respektivisht kemi të bëjmë me humbjen e jetës së tani të ndjerit-S. S., rrethanë rënduese është fakti se i akuzuari ditën kritike kishte dalë komplet në shiritin e kundërt me ç’rast kishte penguar lëvizjen normale të automjeteve duke u ndeshur për ballë, më parë ka qenë i gjykuar për vepra tjera penale nga neni nga neni 140 par.1 të LPK-së, neni 326 par. 2 të KPK-së, neni 260 par. 1 të KPK-së, dhe ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale. Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, gjykata të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo veprë penale është shumë e shpeshtë në vendin tonë, vetëm për shkak të mos mosrespektimit të rregullave të komunikacionit. Dhe kjo gjykatë konsideron se dënimet e shqiptuara në këto raste duhet të jenë në proporcion me shkallën e lartë të rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjikata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në

parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar u muar në kuptim të nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u muar në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.1013/13,dt.18.06.2014

Sekretare Juridike
Mihrie Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.